

Drejtori IKRTK-së

1. IKRTK-ja drejtohet dhe përfaqësohet nga drejtori, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e IKRTK-së dhe përgjigjet para ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
2. Drejtori i IKRTK-së emërohet dhe lirohet nga detyra nga ministri përgjegjës për Trashëgiminë kulturore. Procedura e emërimit dhe e lirimit të tij përcaktohet në statutin e institucionit.
3. Drejtori i IKRTK-së është punonjës i nivelit të lartë drejtues, përgjegjës kryesor për mbarëvajtjen e punës në institucion. Koordinon punën vertikalisht me strukturat që ka në varësi.
4. Drejtori i IKRTK-së ka kompetencat dhe përgjegjësitë, si më poshtë vijon
 - a) analizon, zbërthen dhe siguron zbatimin e vendimeve lidhur me politikat e ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;
 - b) është përgjegjës për hartimin e objektivave dhe zbatimin e planeve strategjike në përputhje me objektivat dhe misionin e IKRTK-së;
 - c) monitoron dhe kontrollon faktorët e riskut që venë në rrezik arritjen e objektivave të IKRTK-së;
 - d) planifikon, drejton dhe koordinon funksionimin e përgjithshëm të institucionit;
 - e) shpërndan punën brenda institucionit dhe siguron arritjen e rezultateve në kohë dhe me cilësi, sipas objektivave të planifikuar;
 - f) nxjerr vendimin për verifikimin e interesit kulturor në bazë të vendimit të Komisionit Këshillimor për Vlerësimin dhe Identifikimin e Vlerave Kulturore për Pasuritë e Luajtshme.
 - g) shpall në “mbrojtje paraprake” pasuritë kulturore të luajtshme, të cilat, pas verifikimit, janë identifikuar si pasuri me vlera kulturore
 - h) shqyrton ankimin ndaj vendimit të zyrës për çështjet e eksportit për refuzimin e kërkesës për lëshimin e licencës së qarkullit të lirë ose të përkohshëm. Ndaj vendimit të titullarit të IKRTK-së mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative.
 - i) akordon licencat e eksportit/importit në bazë të vendimit të zyrës për çështjet e eksportit në mbështetje me parashikimet e Ligjit nr.27/2018 dhe të klasifikuara në dy kategori:
 - i. Licenca eksporti të pasurive kulturore për qarkullimin e lire të pasurive kulturore nga territori i Republikës së Shqipërisë drejt vendeve të tjera me afat 3-vjeçar dhe licenca për qarkullimin e përkohshëm të pasurive kulturore nga territori i Republikës së Shqipërisë drejt vendeve të tjera me afat të përcaktuar jo më shumë se 18 (tetëmbëdhjetë) muaj.
 - j) emëron dhe shkarkon punonjësit e IKRTK-së, në bazë të Kodit të Punës dhe të rregullores së brendshme të IKRTK-së;
 - k) ndjek rregullisht proceset administrative dhe merr masa për zgjidhjen e problemeve;
 - l) siguron/garanton që burimet në dispozicion të Institucionit të organizohen në mënyrë që objektivat e saj të realizohen me efektshmëri të lartë, në mënyrë tërësisht të rregullt dhe korrekte;
 - m) përfaqëson institucionin në marrëdhëniet me të tretët;

- n) përgjigjet për zgjidhjet ligjërish të bazuara dhe teknike të problemeve brenda Institucionit, duke bashkëpunuar me të gjitha strukturat që e konsideron të nevojshme;
- o) siguron disiplinën në strukturën që drejton dhe në bazë të legjislacionit në fuqi, brenda kompetencave ligjore, merr masa për çdo punonjës që thyen rregullat në administratën publike;
- p) drejton punën me sektorët lidhur me botimet vjetore, ribotime të tjera, albume e guida.
- q) realizon detyrat e ngarkuara nga ligji, brenda afatit dhe raporton mbi to.

Përgjegjësi i Sektorit

1. Përgjegjësi i Sektorit është punonjës i nivelit të ulët drejtues, përgjegjës kryesor për mbarëvajtjen e punës në sektorin përkatës. Koordinon punën brenda Sektorit me specialistët që varen direkt prej tij;
2. Përgjegjësi i Sektorit përgjigjet për:
 - a) zgjidhjet ligjërish të bazuara dhe teknike të problemeve brenda sektorit që drejton dhe mund të bashkëpunojë me të gjitha strukturat brenda dhe jashtë sektorit për zgjidhjen e problemeve të ndryshme;
 - b) mosmarrëveshjet në lidhje me kompetencat, njofton menjëherë sipas radhës drejtorin e Institucionit, në cilësinë e eprorit direkt, i cili ndjek me pas zgjidhjen e konfliktit;
 - c) përfundimin e detyrave të ngarkuara nga ligji, ose nga eprorët brenda afatit;
 - d) çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga eprorët.

Specialisti

1. Specialistët janë punonjës të nivelit ekzekutiv në sektorin përkatës;
2. Zbatojnë me përpikmëri dhe në nivel të lart profesional të gjitha detyrat e ngarkuara nga Përgjegjësi i Sektorit dhe titullari;
3. Specialisti përgjigjet për:
 - a) zgjidhjet ligjërish të bazuara dhe teknike të problemeve brenda sektorit, në përputhje me përshkrimin e punës;
 - b) bashkëpunon me të gjitha strukturat brenda dhe jashtë Institucionit për zgjidhjen e problemeve të ndryshme;
 - c) mosmarrëveshjet me strukturat e tjera brenda Institucionit dhe njofton menjëherë Përgjegjësin e Sektorit/Drejtorin, i cili ndjek më pas zgjidhjen e konfliktit;
 - d) realizimin e detyrave të ngarkuara nga ligji, ose nga eprorët brenda afatit dhe raportimin e tyre;
 - e) çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga eprorët.